

27 nëntor, 2008

NJOFTIM PËR SHTYP

BANKAT QENDRORE TË EUROSISTEMIT DHE TË RAJONIT TË MESDHEUT MBLIDHEN NË SEMINARIN E PESTË EURO-MESDHETAR

Në datën 27 nëntor 2008, Banka Qendrore e Egjiptit, në bashkëpunim me Bankën Qendrore Evropiane, organizoi në Aleksandri, Egjipt, seminarin e pestë të nivelit të lartë Euro-Mesdhetar, i cili mbledh së bashku bankat qendrore të Eurosistemit dhe të rajonit të Mesdheut.

Pjesëmarrësit në këtë seminar u përshëndetën nga Presidenti i Bankës Qendrore Evropiane, z. Jean-Claude Trichet, si dhe nga Guvernatori i Bankës Qendrore të Egjiptit, z. Farouk El Okdah. Të ftuar në këtë seminar, ishin guvernatorët dhe përfaqësuesit e nivelit të lartë të bankave qendrore të Eurosistemit, përkatësisht të Austrisë, Belgjikës, Qipros, Finlandës, Francës, Greqisë, Gjermanisë, Holandës, Irlandës, Italisë, Luksemburgut, Maltës, Portugalisë, Sllovenisë dhe Spanjës, si dhe guvernatorët dhe përfaqësuesit e nivelit të lartë të bankave qendrore të Shqipërisë, Algjerisë, Egjiptit, Izraelit, Libanit, Libisë, Mauritanisë, Marokut, Autoritetit Kombëtar Palestinez, Sirisë dhe Turqisë. Pjesëmarrës në këtë seminar ishin gjithashtu, edhe përfaqësues nga Komisioni Evropian dhe nga Banka Evropiane për Investime.

Takimi i mbajtur në Aleksandri, dëshmoi të ishte një platformë e nevojshme për zhvillimin e diskutimeve shumëpalëshe dhe për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi çështje të interesit të përbashkët, nga pikëpamja e bankingut qendror. Seminari i këtij viti, u përqendrua në zhvillimet e fundit ekonomike dhe financiare në vendet e rajonit të Mesdheut, në strategjitë e politikës monetare dhe regjimet e kursit të këmbimit në rajon, si dhe në tendencat e vërejtura në sektorët bankarë përkatës të vendeve të rajonit të Mesdheut, me fokus të veçantë diskutimin e implikimeve të trazirave në tregjet financiare globale.

Zhvillimet e fundit ekonomike dhe financiare në vendet e rajonit të Mesdheut

Pjesëmarrësit në seminar theksuan faktin, se zhvillimet makroekonomike në rajon kanë qenë përgjithësisht të favorshme, të karakterizuara nga një rritje e fortë ekonomike, e cila i ka bërë ballë ngadalësimit ekonomik global. Presionet inflacioniste në rritje, si rezultat i faktorëve të brendshëm dhe atyre globalë, përkatësisht rritja e çmimit të naftës dhe e ushqimeve, kanë qenë

një tendencë e përbashkët në rajon. Pjesëmarrësit ranë dakord për faktin, se mbajtja nën kontroll e inflacionit, shmangia e efekteve të raundit të dytë dhe ankorimi i pritshmërive inflacioniste drejt niveleve që janë në linjë me ruajtjen e stabilitetit të çmimeve mbeten sfida për periudhën afatshkurtër. Në të njëjtën kohë, faktorët që shtojnë rrezikun për rritjen e inflacionit, veçanërisht ato të lidhura me çmimet globale të mallrave, po zbuten ndjeshëm. Pjesëmarrësit gjithashtu, u shprehën se faktorët që rrezikojnë rritjen ekonomike janë rritur, si rezultat i ngadalësimit të aktivitetit ekonomik global. Në këtë kontekst, u diskutuan edhe efektet e mundshme që mund të kenë zhvillimet në ekonomitë e vendeve të zhvilluara, në këtë rajon. Në këtë takim, u ra dakord për faktin se krijimi i vendeve të punës mbetet sfida kryesore ekonomike dhe shoqërore, në periudhën afatmesme dhe atë afatgjate. Në vijim, pjesëmarrësit diskutuan mbi shkallën, me të cilën riciklimi rajonal i të ardhurave nga nafta ka një ndikim pozitiv indirekt mbi ecurinë ekonomike të vendeve joeksportuese të naftës, kryesisht përmes flukseve hyrëse të kapitalit nga vendet eksportuese të naftës, në rajonin e Gjirit.

Strategjitë e politikës monetare dhe regjimet e kursit të këmbimit në vendet e rajonit të Mesdheut: zhvillimet aktuale dhe ato të pritshme

Pjesëmarrësit në seminar, shqyrtuan strategjitë e politikës monetare dhe regjimet e kursit të këmbimit në rajon. Në shumë vende të rajonit të Mesdheut, kuadri i politikës monetare është përmirësuar, ndërkohë që shumë vende të rajonit po zhvendosen drejt një fleksibiliteti më të madh të kursit të këmbimit dhe drejt vendosjes së objektivave më të orientuar. Të pranishmit pranuan progresin e arritur në drejtim të liberalizimit të llogarisë së kapitalit, si një faktor nxitës i këtij zhvillimi. Në këtë kontekst, disa vende të rajonit të Mesdheut kanë publikuar kohët e fundit synimin e tyre për adoptimin e regjimit të inflacionit të shënjestruar. Gjithashtu, pjesëmarrësit shkëmbyen pikëpamjet e tyre, lidhur me kushtet ekonomike, institucionale dhe teknike për zbatimin e regjimit të inflacionit të shënjestruar, me progresin e arritur në këto drejtime në vendet që synojnë adoptimin e këtij regjimi, si dhe me përvojat e vendeve që tashmë e zbatojnë atë.

Zhvillimet në sektorët bankarë përkatës të vendeve të rajonit të Mesdheut dhe implikimet për stabilitetin financiar

Pjesëmarrësit në seminar, diskutuan zhvillimet që kanë karakterizuar sektorët financiarë të vendeve të rajonit të Mesdheut. Ata përmendën reformat e shumta të ndërmarra në kuadrin

Banka Qendrore Evropiane:

Departamenti i Komunikimit/Sektori i Shtypit dhe i Informacionit

Kaiserstrasse 29, D-60311 Frankfurt am Main

Tel.: + 49 69 1344 7455, Faks: + 49 69 1344 7404

Internet: <http://www.ecb.europa.eu>

Riprodhimi i këtij materiali është i lejuar, me kusht që të përmendet burimi i tij.

ligjor dhe atë rregullator gjatë viteve të fundit, si dhe shprehën synimin e tyre për vijimin e dhënies së mbështetjes në fushën e privatizimit dhe në hyrjen e bankave të huaja. Për shumë vende, lehtësimi i procesit të kredithënies për sektorin bankar dhe huatë me probleme mbeten çështje me prioritet. Pjesëmarrësit ranë dakord për faktin, se zhvillimi i mëtejshëm i sistemit bankar dhe atij financiar është thelbësor për përmirësimin e ndërmjetësimit financiar, për mbështetjen e rritjes ekonomike, si dhe për integrimin e mëtejshëm të rajonit të Mesdheut në ekonominë globale.

Banka Qendrore Evropiane:

Departamenti i Komunikimit/Sektori i Shtypit dhe i Informacionit

Kaiserstrasse 29, D-60311 Frankfurt am Main

Tel.: + 49 69 1344 7455, Faks: + 49 69 1344 7404

Internet: <http://www.ecb.europa.eu>

Riprodhimi i këtij materiali është i lejuar, me kusht që të përmendet burimi i tij.